



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 429, datë 14.10.2020

PËR

**CAKTIMIN E GJYQTARIT TË SKEMËS SË DELEGIMIT
Z.{...}, NË GJYKATËN E APELIT SHKODËR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a” të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të situatës aktuale dhe nevojave të Gjykatës së Apelit Shkodër, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për periudhën deri më datë 14.10.2021.
2. Gjyqtari në skemën e delegimit z. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën e Apelit Shkodër, për periudhën deri më datë 30.10.2020.
3. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.
4. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Apelit Shkodër.
5. Një kopje e vendimit i njoftohet Gjyqtari në skemën e delegimit z. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Apelit Shkodër.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR